



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

DHOMA E DYTE E GJYKATES KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2020:136344

Datë: 10.06.2024

Numri i dokumentit: 05799809

K.DH.SH.II.nr.852/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS -Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Saranda Bogaj Sheremeti, kryetare e kolegjit, Faton Bajrami dhe Franciska Zhitija Ymeri, anëtar të kolegjit, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit “Apetit” Sh.p.k me seli në Vushtri, të cilën e përfaqëson sipas autorizimit avokat Labinot Murati nga Prishtina kundër të paditurës Dogana e Kosovës (DK), në Prishtinë, të cilën e përfaqëson sipas autorizimit Blerta Gagica, me bazë juridike, anulim vendimi, duke vendosur lidhur me ankesën të paditurës, ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës-Dhomat e Shkallës së Parë-Departamenti Fiskal, KF.nr.58/24, i datës 29.02.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 31.05.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e të paditurës Dogana e Kosovës (DK), në Prishtinë, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës-Dhomat e Shkallës së Parë-Departamenti Fiskal, KF.nr.58/24, i datës 29.02.2024, **Vërtetohet**.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e ankimuar të Gjykatës Komerciale të Kosovës-Dhomat e Shkallës së Parë-Departamenti Fiskal, në pikën paragrafin e parë të dispozitivit është vendosur: **APROVOHET** në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësit Apetit Sh.P.K., me seli në Magjistralen Prishtinë - Mitrovicë, Komuna Obiliq, **ANULOHET** aktvendimi me nr.01.3.2.2/9455, 9456, 9457 i datës

10.09.2020 i Doganës së Kosovës me seli në Prishtinë., OBLIGOHET e paditura Dogana e Kosovës me seli në Prishtinë, që paditësit Apetit Sh.P.K., me seli në Magjistralen Prishtinë - Mitrovicë, Komuna Obiliq, t'ia kthej shumën prej 3,172.63 €, (tremijë/e/njëqind/e/shtatëdhjetë/e/dy/euro/e/gjashtëdhjetë/e/tre /centë), të paguar më tepër në emër të detyrimeve doganore, për shkak të rivlerësimit të mallit të zhdoganuar përmes Deklaratës Unike Doganore me nr. R-22529/16.07.2020, R-22426/16.07.2020 dhe R-23551/23.07.2020, të proceduar në Zyrën e Brendshme Doganore Prizren, me kamatë ligjore prej 8% nga data e paraqitjen së padisë 14.10.2020 e deri në pagesën e plotë. Dhe secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë, përfaqësuesja e autorizuar e të paditurës, Dogana e Kosovës (DK), në Prishtinë, me të cilën e ka kundërshtuar të njëjtin për shkak të: shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet në tërësi si e bazuar ankesa, të prishet aktgjykimi KF.nr.58/24, i datës 29.02.2024, si i pa bazuar me ligj, të refuzon padinë dhe kërkesën e paditësit në tërësi si të pa bazuar me ligj dhe të lënë në fuqi vendimin e kontestuar ose t'ia kthej Gjykatës Komerciale të Kosovës-Dhoma e Shkallës së Parë-Departamenti Fiskal në rivendosje.

Përgjigje në ankesë ka parashtruar pala paditëse me të cilën ka propozuar që të refuzohet ankesa e të paditurës si e pabazuar dhe të vërtetohet aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë.

Gjykata Komerciale-Dhoma e shkallës së Dytë, shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore në ankesë, dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 49 të LKA-së, nenit 81.H të Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat nr.03/L-222, lidhur me nenin 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), gjeti se:

Ankesa është e pa bazuar

Nga shkresat e lëndës rezulton se e e paditura Sektori për Rishqyrtimin e Vendimeve-Dogana e Kosovës ka refuzuar kërkesën e paditësit për rishqyrtimin e DUD-ve R-22529/16.07.2020, R-22426/16.07.2020 dhe R-23551/23.07.2020, të ZBD Prizren.

Paditësi i pakënaqur me vendimin e të paditurës, ka ushtruar padi për konflikt administrativ, me pretendim se i njëjti është i padrejtë dhe i paligjshëm. Gjykata e shkallës së parë, pas shqyrtimit të padisë së paditësit, si dhe pas administrimit të provave si në procesverbal të shqyrtimit kryesor, merr aktgjykimin e ankimuar me të cilin kërkesëpadinë e paditësit e aprovon si të bazuar, duke vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar. Në arsyetim të aktgjykimit ndër të tjera ka theksuar se pas administrimit të provave të kësaj çështje administrative doganore ka konstatuar se dokumentacioni i prezantuar nga paditësi është i pa kontestueshëm nga pikëpamja ligjore për zhdoganim të mallit lëndor në pajtim me nenin 33 të Kodit Doganor dhe Akcizave.

Qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e pranon edhe kjo gjykatë, për arsye se aktgjykimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative, të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative. Gjykata e shkallës së parë duke vlerësuar ligjshmërinë e aktvendimit të kontestuar në kuptim të nenit 44 par.1 të Ligjit për Konfliktet Administrative, në drejtim të thënieve në padi, në përgjigje në padi, provave të administruara në seancë gjyqësore, si dhe pas shqyrtimit të shkresave të tjera të lëndës me të drejtë ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit duke vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar. Sa i përket pretendimeve ankimore të përfaqësueses së autorizuar të paditurës, se gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës, këto pretendime ankimore nuk qëndrojnë, ngase aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë nuk është i përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës administrative, e as me shkelje të tjera të cilat do të ndikonin në drejtëshmërin dhe ligjshmërinë e aktgjykimit të goditur. Meqë gjykata ka shqyrtuar padinë, fillimisht e ka dërguar padinë përfaqësuesit të paditurës në përgjigje në padi, pastaj ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor, ka nxjerr prova të mjaftueshme, që do të thotë se gjatë vlerësimit gjykata e shkallës së parë nuk ka bërë shkelje të dispozitave të LKA-së, dhe LPA-së. Ndërsa, sa i përket pretendimeve ankimore të përfaqësueses së autorizuar të paditurës, për vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, këtë pretendim e Kolegji i Gjykatës Komerciale- Dhoma e shkallës së Dytë, e refuzon si të pa bazuar. Në rastin konkret kjo gjykatë, as në ankesë, e as në shkresat e lëndës, nuk ka gjetur asnjë provë që është e bazuar në ligj mbi bazën e të cilave e paditura e ka ngarkuar paditësin me pagesë shtesë në emër të taksave doganore importuese.

Gjykata nga shkresat e lëndës vlerëson se me asnjë provë nuk është provuar konstatimi i të paditurës i dhënë në vendimin e kontestuar, sipas të cilit vlera e deklaruar e mallit lëndor nga

paditësi, nuk është vlera reale e paguar e mallit me qëllim importi në vendin tonë në vështrim të nenit 33 të KDAK-së. Gjykata konsideron se paditura do të mund ta mbështetet një konstatim të këtillë vetëm atëherë kur do të mund të siguronte dëshmi konkrete se paditësi për mallin lëndor kontestues, i ka paguar eksportuesit mbi çmimin neto të faturës të mallit, ku vlera e mallit të faturuar nga eksportuesi është paguar nga paditësi përmes urdhërpagesave ndërkombëtare me status të aprovuar të datës, e të cilat janë në harmoni të plotë në kuptim të shumës dhe përshkrimit si në faturë.

Në raport me pretendimet e të paditurës se paditësi nuk ka prezentuar dokumentacion të mjaftueshëm me të cilat paditësi do të vërtetonte se vlera e paguar për mallin kontestues është reale, Dhoma e shkallës së dytë gjen se se në rastin konkret paditësi ka paraqitur faturën e mallit lëndor dhe e cila është paguar përmes urdhërpagesave bankare ndërkombëtare me status të aprovuar, e të cilat janë të harmonizuara në tersi në kuptim të shumës dhe pagesës së bërë. Në këto rrethana, Gjykata vlerëson se të gjitha këto dokumente rezultojnë të jenë të harmonizuara në tërësi sa i përket vlerës së mallit të importuar nga paditësi në kuptim të nenit 33 par.1 të KDAK-së.

Andaj gjykata e shkallës së parë drejtë ka vendosur duke bërë interpretimin e drejtë të dispozitave ligjore sa i përket dokumenteve që duhet ti bashkëngjiten deklaratës doganore gjatë zhdoganimit të mallit, dhe nga kjo rezulton se paditësi ka paraqitur transaksionin bankar duke përshkruar edhe numrin e faturës për pagesën e mallit lëndor i cili dëshmon çmimin e blerjes realisht të paguar.

Nga tërë kjo që u cekë më lartë dhe mbi këtë gjendje faktike, kjo gjykatë konsideron se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, ngase nuk është cenuar ligji në dëm të paditurës. Prandaj, pretendimet ankimore në ankesë se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar edhe të drejtën materiale në dëm të paditurës, ky kolegji nuk i aprovoi, sepse vlerësoi se te njëjtat janë të paqëndrueshme dhe të pa bazuara për tu aprovuar ankesa, dhe se janë të pa ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike nga ajo e vërtetuar edhe nga gjykata e shkallës së parë. Sepse, aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë, është i qartë dhe i kuptueshëm si dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare, të cilat i pranon edhe kjo gjykatë, andaj, ankesat, e të paditurës u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm. Duke marrë parasysh se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale, me rastin e aprovimit të kërkesëpadisë

së paditësit, e pasi që me pretendimet tjera ankimore të përsëritura, të njëpasnjëshme, një aktgjykim i tillë nuk mund të vihet në pyetje, ankesa e të paditurës, u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

K.DH.SH.II.nr.852/24, me datë 31.05.2024

**Kryetare e kolegjit,
Saranda Bogaj Sheremeti**